



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2092

Tirane, date 23.1.2015

Drejtuar: Z. Eduart Keta, Administrator
Shoqëria "Egi-K" Shpk
Lagje Qyteti i Ri

BULQIZE

Për dijeni: z. Luan Saliaj, Administrator,
Albchrome shpk
Pall. Classic Construction, Kati 2, Rruga Budi, ZK8160

TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave për revokimin e lejes minerare nr.1459, date 03.03.2010.

I nderuar zoti Keta,

Shoqëria "Egi-K" shpk është zotëruese e leje minerare te shfrytëzimit nr.1459, date 03.03.2010, për shfrytëzimin e sterileve të kromit në objektin Bulqize, Qarkun Dibër.

Në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me kërkesë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.2200/1, date 16.02.2014 ka dërguar dokumentacionin e verifikimeve të mbivendosjeve të lejeve minerare në zonën e Bulqizës.

Neni 47, pika a1, e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, përcakton se një leje minerare revokohet kur:
a/1) konstatohet se zona e licencuar ka mbivendosje të plotë ose të pjesshme, me një leje minerare që është dhënë më parë konform legjislacionit në fuqi në atë periudhë kohore. Në këtë rast, leja minerare, e cila është dhënë në një periudhë kohore të mëvonshme është e pavlefshme për zonën e mbivendosur dhe ministri e revokon atë vetëm për zonën e mbivendosur. Po kështu, ju bejme me dije se, leja minerare nr.1459, datë 03.03.2010, bie pjesërisht mbi zone të rrezikshme minerare, ku ndalohet zhvillimi i aktivitetit minerar (VKM nr.347, datë 29.04.2011), ndërsa pjesa e mbetur nuk i plotëson kushtet e sipërfaqes minimale të një leje minerare kromi.

Sa me sipër ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit të lejes minerare nr.1459, date 03.03.2010.

Ju bëjmë me dije se Ministri vendos revokimin e lejes minerare 30 ditë kalendarike pas kalimit të afateve të përcaktuara për njoftimin e dërguar me poste ose te publikuar ne faqen e MEI.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304, date 15.07.2010, “Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

